



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2022:196585

Datë: 18.12.2023

Numri i dokumentit: 05081131

PPP. nr. 5/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC- Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Astrit Gashi, në çështjen juridike përmbarimore të Kreditorit T... SH.A me seli në Prishtinë, kundër debitorit S.I nga Komuna Glllogocit, lidhur me borxhin në shumën prej 7,782.55 €, duke vendosur në prapësimin e ushtruar nga debitori S.I kundër Urdhërit për lejimin e përmbarimit të Përmbaruesit privat V.B, P. nr... të datës 18.12.2019, jashtë seance me datën 18.12.2023 e mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET prapësimi i debitorit S.I nga Komuna Glllogoc ushtruar kundër Urdhërit të Përmbaruesit Privat V.B, P. Nr... të datës 18.12.2019 me të cilin është lejuar propozimi i kreditorit, për përmbarimin e borxhit në shumën prej 7,782.55 €, ndërsa **urdhëri** i Përmbaruesit Privat P. nr... i datës 18.12.2019 për sekuestrim të kolateralit **mbetet në fuqi**.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat V.B, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, ka lëshuar Urdhër me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të Marrëveshjes mbi Kredinë me nr... e datës 28.02.2017 i cili është dokumenti besueshëm i cili sipas Nenit 21 të LPP-së paraqet bazë juridike për caktimin e përmbarimit ndërsa në bazë të Nenit 29 të këtij ligji është dokument i besueshëm.

Kundër urdhërit për lejimin e përmbarimit në afat ligjor debitori S.I ka paraqit prapësim në bazë të Nenit 69, 70, 71 të LPP-së, me arsyetimin se: *debitorët asnjëherë nuk kanë pranuar nga Kreditori asnjë vërejte me shkrim për pagesë dhe se kreditori nuk ka ndonjë provë, po ashtu sipas mendimit të tyre lidhur me dokumentin bazë për përmbarim siç është Urdhëri Përmbarimor P. nr... i datës 18.12.2019 të cilën e ka sjell pala kreditore aq sa kanë vërejtur në asnjë klauzolë nuk shënon se palët janë marr vesh që kontrata e kredisë të këtë titull ekzekutiv dhe si dokument është i pa qëndrueshëm në pikëpamje të ekzekutimit në këtë procedurë, tutje shtojnë faktin se debitori B.I ka vdekur dhe për këtë i ka bashkangjitur Çertifikatën e vdekjes të datës 09.07.2019 dhe për këtë fakt debitori S.I tani ka mbetur pa bashkëshort dhe është në gjendje të dobët ekonomike dhe materiale dhe e njëjta jeton vetëm me një asistencë sociale dhe nuk ka të ardhura tjera, e njëjta thekson se borxhi në fjalë është parashkruar pasiqë për realizimin e kësaj shume*

si në aktgjykim është vjetërsuar sipas Nenit 71 par.1 pika 1.4 të LPP-së, dhe ka kërkuar nga gjykata që të mbajë seancë gjyqësore për të u dëgjuar palët në mënyrë që të vërtetohet drejtë gjendja faktike, andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzoj Urdhërin përmbarimor P.nr... të dt. 18.12.2019.

Kreditori në afatin ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim me të cilin ka kundërshtuar prapësimin e debitorëve me arsyetimin se debitori prapësimin e ushtruar ka theksuar: *se nuk është njoftuar për vonesën nga Kreditori, kjo nuk qëndron pasiqë i njëjti vazhdimisht është njoftuar me shkrim (vërejtje pagese), i është dërguar SMS dhe është vizituar disa herë nga stafi i Kreditorit, debitori po ashtu nga vet mungesa e pagesave ka qenë e vetëdijshme se këstet e kredisë nuk janë duke u paguar dhe rrjedhimisht mund të fillohet procedura e përmbarimit, ndërsa sa i përket pretendimit se borxhi është parashkruar nuk qëndron sepse kredia është e vërtetë që është lëshuar në vitin 2014 por vonesa është bërë me datën 02.07.2019, ndërsa sa i përket gjendjes së dobët ekonomike dhe vdekjes së bashkëshortit të debitorës, janë në gjendje të takohen dhe të bisedojnë për arritjen e një marrëveshje të pranueshme nga të dyja palët, duke i propozuar gjykatës që pas shqyrtimit të lëndës në përgjithësi të refuzoj prapësimin e debitorit dhe urdhëri të mbet në fuqi.*

Gjykata lidhur me këtë çështje nuk ka mbajtur seancën konform Nenit 73 par. 1 të LPP-së, pasi që vlerësoj se ka prova te mjaftueshme dhe e ka të qartë për të vendosur mbi këtë çështje përmbarimore.

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palëve vërtetoi se: prapësimi i debitorës e datës 23.12.2019 është i pabazuar, me faktin në shkresat e lëndës gjendet Kontrata e Kredisë me nr... e datës 28.02.2017 mes Kreditorit T... SH.A dhe Debitorëve B.I dhe S.I me të cilën janë pajtuar për kushtet dhe mënyrën e kthimit te kredisë si dhe afatin e që është caktuar në bazë të kontratës për kredinë, si dhe marrëveshja mbi pengun me të cilën palët debitorët janë pajtuar për të dhënë peng sendet e luajtshme ku në bazë të listës figurojnë gjerat dhe sendet e listuara.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit sa i përket parashkrimit dhe vlerësoj se nuk qëndron pretendimi i debitorit mbi bazën e parashkrimit siç janë thirrur në prapësim, mirëpo e njëjta ka rënë në vonesë dhe nuk i është përmbajtur marrëveshjes dhe si rrjedhojë e kësaj debitori ka kaluar afatin për përmbushje vullnetare të borxhit.

Gjykata pas analizimit të gjitha provave që gjenden në shkresat e lëndës ka ardhur në përfundim se Debitorët kanë rënë në vonesë në pagesë debitorët nuk kanë paguar këstin dhe nuk e kanë respektuar Kontratën për Kredinë edhe pas paralajmërimeve që i janë bërë nga Kreditori, ndërsa sa i përket parashkrimit gjykata konsideron se nuk është e bazuar sepse Kreditori ka bërë me kohë paralajmërimin për vonesë, dhe me kohë ka paraqitur Propozimin për përmbarim, dhe në bazë të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve në Nenin 342 par.2 përcakton se “Në qoftë se detyrimi konsiston në atë që diçka të mos bëhet, të lihet pa u bërë ose të pësohet, parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur debitori të ketë vepruar në kundërshtim me detyrimin”, kurse afati për parashkrim është paraparë me Nenin 355 par.1 të LMD-së i cili përcakton se: *Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite.* Andaj gjykata gjeti si të pa bazuar prapësimin e debitorit.

Gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës duke vendosur dhe atë duke u bazuar në Nenin 21 dhe 29 pasi që Kontrata mbi Kredinë Konsumuese është dokument i besueshëm, dhe në bazë të Ligjit të Procedurës Përmbarimore Neni 29 par. 1 i

cili përcakton se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1. kambialet dhe çeket me potest dhe faturë kthyesë, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës; 1.2. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave; 1.3. faturat; 1.4. dokumentet që sipas dispozitave ligjore të posaçme kanë rëndësinë e dokumenteve publike; 2. Llogaritja e kamatës konsiderohet si pjesë e dokumentit të besueshëm. 3. Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”. Ndërsa, Marrëveshja mbi pengun e përmbajtur në Kontratën për Kreditinë konsumuese është dokument i përmbarueshëm në kuptim të Nenit 22 par. 1.7 të LPP-së lidhur me Nenet 14, 15, 16, 23 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-136 për Regjistrimin e Pengut në Regjistër për Sendet e Luajtshme) dhe Nenet 37, 38 dhe 40 të LPP-së. Një marrëveshje e tillë është e regjistruar pranë Zyrës për Regjistrim të pengut të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë me nr. R-... datë 03.06.2014 me dobi të kreditorit-pengmarrësit N...

Andaj, gjykata vendosi që të refuzoj prapësimin si në dispozitiv të këtij aktvendimi pasi që faturat konsiderohen të jenë dokumente të besueshme.

Nga arsyet e paraqitura, në bazë të Nenit 73 par 3. të LPP, kjo gjykatë gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar dhe vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Dega në Gllogoc
Departamenti i Përgjithshëm, PPP. nr. 5/25, datë 18.12.2023

Gj y q t a r i
Astrit Gashi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi nuk e ndalon procedurën përmbarimore përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë sipas Nenit 78 të LPP-së.